



Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare

Fusha: Jeta dhe puna

Konceptet e përgjithshme dhe përshkrimi i tyre

Konceptet e fushës së kurrikulës *Jeta dhe puna* që janë zhvilluar në nivelin e dytë të arsimit, vazhdojnë të zhvillohen edhe në nivelin e tretë të arsimit, përkatësisht në shkallet 5-6 të kurrikulës, por në këtë TIK-u është koncept në vete dhe është pjesë integrale e të gjitha koncepteve të fushës. Konceptet e kësaj fushe janë si më poshte:

1. Teknologji e Informimit dhe Komunikimit-TIK
2. Punë dhe edukim për ndërmarrësi
3. Këshillim dhe orientim në karrierë
4. Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm

Konceptet e fushës së kurrikulës *Jeta dhe puna* që janë zhvilluar në nivelin e dytë të arsimit, vazhdojnë të zhvillohen edhe në nivelin e tretë të arsimit, përkatësisht në shkallet 5-6 të kurrikulës, por në këtë TIK-u është koncept në vete dhe është pjesë integrale e të gjitha koncepteve të fushës. Konceptet e kësaj fushe janë si mëposhte

Teknologji e Informimit dhe Komunikimit-TIK

TIK ofron mbështetje nxënësve në zhvillimin e personalitetit për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t'u përvetësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me TIK-un.

Nxënësit përvetësojnë shkathtësi të përdorimit të TIK-ut për gjetjen, zhvillimin, analizimin dhe prezantimin e informacioneve, si dhe të modeleve për zgjidhjen e problemeve në situata të caktuara.

Punë dhe edukim për ndërmarrësi

Zhvillimi i ndërmarrësisë u mundëson nxënësve hulumtimin e tregut të punës, në krijimin e ideve kreative për punësimin dhe vetëpunësimin e tyre. Arritja e kompetencave të ndërmarrësisë, siç janë planifikimi i biznesit, administrimi, marketingu, menaxhimi me burime njerëzore, menaxhimi i projekteve.

Këshillim dhe orientim në karrierë

Të zhvillojë tek nxënësi aftësi për të zbuluar mundësitë e karrierës, si dhe për të vetëvlerësuar interesat dhe prirjet e veta me qëllim vendimmarrjen për shkollimin / trajnimin e mëtejshëm

dhe punësimin, për të qenë pjesëtar funksional i shoqërisë.

Është shumë e rëndësishme që nxënësi të ketë informacion të plotë lidhur me tregun e punës në lokalitetin e tij, në shkallë vendi, si dhe në tregun botëror të punës. Në vija të përgjithshme jepet informacion mbi tregun lokal të punës. Nxënësi do të punojë shumë për të njohur më mirë veten.

Edukimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm orienton nxënësit në zbatimin e qëndrimeve, botëkuptimeve dhe shprehive si qytetar aktiv i shoqërisë. Përmes punës vullnetare kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, politikave dhe mjedisit, duke promovuar edukimin për zhvillim të qëndrueshëm.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS: JETA DHE PUNA
Shkalla kurrikulare 1
1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet
Nxënësi/ja:
1. Përshkruan ndryshimet dhe ngjashmëritë ndërmjet aktiviteteve që bëhen në shtëpi në shkollë dhe në klasë
2. Zbaton veprimtari praktike të thjeshta në familje, në shtëpi dhe në klasë, bazuar në detyrat e caktuara qartë nga mësuesi dhe nga prindërit
2. Ngritja e cilësive personale për jetë dhe punë
Nxënësi/ja:
1. dallon ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet moshatarëve në klasë dhe në shkollë sa u përket talenteve, interesave dhe prirjeve për aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës
3. Përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme
Nxënësi/ja:
1. Identifikon veglat, pajisjet dhe makinat e thjeshta të ekonomisë familjare
2. Identifikon veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar prodhime të thjeshta bazuar në iniciativa personale apo të propozuara nga mbikëqyrësi ose mësuesi
4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme
Nxënësi/ja:
1. Përdor kompjuterin personal për komunikim fillestar
2. Përdor sigurt TIK-un për kryerjen e detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathëive përmes projekteve sipas nivelit.
5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe planit të biznesit
Nxënësi/ja:
1. Përmes veprimeve praktike në ekonominë familjare kupton dhe përjeton faktorët që duhen marrë në konsideratë
6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe për punë

Nxënësi/ja:
1. Identifikon rregullat për mbrojtje dhe siguri, dallon rreziqet në jetën e përditshme
7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme
Nxënësi/ja:
1. Identifikon aktivitetet dhe bartësit e aktiviteteve që zhvillohen në shtëpi, institucion parashkollor/shkollë dhe komunitet.
8. Komunikimi në / për jetë dhe punë
Nxënësi/ja:
1. Ndjek udhëzimet gjatë aktiviteteve të matjes, të shënimit, të prerjes së sigurt dhe të formësimit të materialeve të ndryshme
9. Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm-mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe e mjedisit
Nxënësi/ja:
1. Identifikon, përshkruan dhe klasifikon materiale ricikluese bazë nga ekonomia familjare, duke i dalluar dhe renditur për përdorim të mëtejshëm.
2. Përshkruan konceptet bazë të shoqërisë, mjedisit dhe ekonomisë familjare.
REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS: JETA DHE PUNA
Shkalla kurrikulare 2
1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet
Nxënësi/ja:
1. Përshkruan ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bëhen individualisht dhe në grup
2. Ndërmerr aktivitete praktike bazuar në vetiniciativë dhe në qasje të pavarura për të finalizuar produkte të ndryshme punëdore, duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim
2. Ngritja e cilësive personale për jetë dhe punë
Nxënësi/ja:
1. demonstroi gatishmëri dhe vetiniciativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup
3. Përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme
Nxënësi/ja:
1. Përdor vegla dhe pajisje shtëpiake në situata të përditshmërisë
2. Përdor veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar prodhime të thjeshta bazuar në udhëzimet e mësimdhënësit
4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme
Nxënësi/ja:
1. Përdor kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare
2. Përdor sigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive praktike.
5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe planit të biznesit
Nxënësi/ja:
1. drejtpërdrejt hulumton dhe përfshihet në aktivitete të ekonomisë familjare dhe ushtron

përgjegjësi elementare organizative-buxhetore, duke zhvilluar shpirtin e ndërmarrësit.
6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe për punë
Nxënësi/ja:
1. Përshkruan rregullat për mbrojtje dhe siguri, nga rreziqet në jetën e përditshme: në shtëpi, në shkollë dhe në mjedis.
7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme
Nxënësi/ja:
1. demonstroi përmes veprimeve të veta nevojën për marrjen e përgjegjësisë, ndarjen e aktiviteteve që zhvillohen në shtëpi, shkollë dhe komunitet.
8. Komunikimi në / për jetë dhe punë
Nxënësi/ja:
1. është i vetëdijshëm për ekzistimin e diversitetit individual në klasë, në shkollë dhe në jetë për të përmirësuar të kuptuarit, dëshirat dhe aspiratat e të tjerëve, duke menaxhuar situatat dhe zgjidhjen e konflikteve në mënyrë konstruktive dhe paqësore
9. Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm-mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe e mjedisit
Nxënësi/ja:
1. Përpunon materiale ricikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtëse për ruajtjen e mjedisit.
2. Zhvillon njohuri dhe shkathtësi për shoqërinë, mbrojtjen e mjedisit, ekonominë familjare dhe përdorimin e TIK-ut.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS: JETA DHE PUNA
Shkalla kurrikulare 3
1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet
1. Zbaton aktivitete individuale dhe në grup në mjedis shkollor dhe në komunitet.
2. Kryen aktivitete konkrete praktike sipas planifikimit të parashtruar,
3. Zhvillon aktivitete praktike përmes punës me projekte në shkollë, shtëpi dhe në ambient të tjera jashtëshkollor.
2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe për punë
1. Shpjegon dhe zbaton udhëzimet e shkruara dhe pasqyrimet pamore për aktivitete të ndryshme praktike.
3. Përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme
1. Analizon doracakët për vegla dhe makina të ekonomisë familjare.
2. Përdor veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar produkte, modele të thjeshta, bazuar në skica dhe udhëzime.
4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme
1. Përdor informacione nga burime elektronike për të qartësuar njohuritë në kontekste të caktuara.
2. Aplikon TIK-un në përmbajtje të lëndëve të ndryshme mësimore drejt digjitalizimit në nxënie.
5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe biznesit

1. Shpjegon aspektin etik dhe ekonomik të ekonomisë familjare e në veçanti veprimet kursimtare në familje.
6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe punë
1. Zbaton rregullat për mbrojtje dhe siguri, parandalon dhe ndihmon në menaxhimin e rreziqeve në punë
7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme
1. Shfaq qëndrime vendimmarrëse në situata të ndryshme duke dhënë arsyetim mbi vendimet që merr.
8. Komunikimi në / për jetë dhe punë
1. Identifikon burime të ndryshme të informimit e të orientimit për arsim, aftësim profesional dhe punësim (në medie, internet etj.)
9. Zhvillimi shoqëror, ekonomik dhe mjedisi
1. Adreson sfidat e së tashmes dhe të ardhmes në mënyrë konstruktive dhe kreative për të krijuar një shoqëri më të qëndrueshme.
2. Angazhohet për ruajtjen e baraspeshës ekologjike të mjedisit.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS: JETA DHE PUNA

Shkalla kurrikulare 4

1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet
1. Analizon punën vullnetare, punësimin dhe vetëpunësimin.
2. Planifikon, organizon dhe merr pjesë në aktivitetet praktike individuale dhe në grup.
3. Planifikon dhe zhvillon aktivitete praktike përmes punës me projekte në shkollë, shtëpi dhe në ambiente tjera jashtëshkollore.
2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe për punë
1. Demonstron shkathtësitë e nevojshme për qasje orientimi në karrierë.
3. Përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme
1. Përdor vegla, pajisje dhe makina punuese bazuar në udhëzime dhe doracakë për përdorim.
2. Përshkruan procesin teknologjik të shfrytëzimit të burimeve natyrore të energjisë.
4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme
1. Zbaton njohuri nga TIK për prezantimin e proceseve të caktuara.
2. Përdor programe kompjuterike për zbatimin praktik të njësive dhe temave mësimore.
5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe biznesit
1. Analizon tregun e punës dhe përgatit pilotplane të biznesit, individualisht apo në grup, dhe i prezanton ato përmes formave të ndryshme të komunikimit
6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe punë
1. Identifikon dhe parandalon rreziqet e ndryshme të cilat mund të ndodhin në vendin ku punon.
7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme
1. Analizon preferencat e profesionit të dëshiruar, duke e argumentuar, me dëshirat, njohuritë dhe shkathtësitë personale.
8. Komunikimi në / për jetë dhe punë

1. Hulumton dhe përdorë burime të ndryshme të informimit për arsimim, aftësim për tregun e punës me qëllim të përzgjedhjes së opsioneve për orientim në karrierë

9. Zhvillimi shoqëror, ekonomik dhe mjedisi

1. Zhvillon aktivitete për çështjet e drejtësisë sociale, etikën dhe mirëqenien, duke lidhur me faktorët socialë, ekonomikë dhe ekologjikë.

2. Analizon dhe vlerëson përparësitë e përdorimit të llojeve të ndryshme të energjisë në ruajtjen e mjedisit ku jeton.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS: JETA DHE PUNA

Shkalla kurrikulare 5

1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet

1. Analizon ndryshimet ndërmjet punës individuale dhe në grupe përkatësisht gjen dallimet dhe ngjashmëritë e punës me projekte.

2. Shfrytëzon njohuritë dhe përvojën personale për të dizajnuar dhe për të zbatuar punë me projekte në shkollë në mënyrë individuale dhe në grup.

2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe punë

1. Demonstron shkathtësitë e nevojshme për të siguruar bazën për zhvillim personal, profesional si dhe mundësi të ndryshme në të nxënësit.

3. Këshillim dhe orientim në karrierë

1. Vlerëson shkathtësitë dhe njohuritë personale lidhur me karrierën e tyre të ardhshme.

2. Ndërlidh njohuritë dhe shkathtësitë personale me nevojat e tregut të punës.

4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme

1. Analizon disa nga përparësitë e përdorimit të TIK-ut për projekte dhe pune hulumtuese.

2. Demonstron shkathësi në përdorimin e aplikacioneve dhe ueb shërbimeve.

5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë

1. Prezanton ide kreative për krijimin e një biznesi duke u bazuar në analizën e tregut të punës.

6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë

1. Identifikon dhe parandalon rreziqet e ndryshme të cilat mund të ndodhin në situata të ndryshme jetësore.

7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme

1. Lexon, interpreton dhe plotëson dokumentacion për nevoja personale duke u bazuar në legjislacion dhe kërkesa të tregut të punës.

8. Komunikimi në / për jetë dhe punë

1. Përdor multimedia për të marrë informacione për implementimin e detyrave dhe projekteve të ndryshme.

9. Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe mjedisit

1. Tregon kujdes për mjedisin e punës dhe arsyeton rolin e teknologjisë në ruajtjen e ambientit.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS: JETA DHE PUNA

Shkalla kurrikulare 6

1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet

1. Hulumton, organizon në mënyrë efektive dhe prezanton informacione për aktivitete praktike individuale dhe në grup.

2. Krijon aktivitete të ndërlidhura me punën individuale dhe në grup gjatë realizimit të produkteve dhe projekteve të caktuara.

2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe punë

1. Vlerëson aftësitë personale dhe profesionale si dhe arritjet e identifikuara në bazë të fushave të ndryshme të interesit sipas objektivave të caktuara për vetëpërmirësim, duke marrë në konsideratë ndikimet në zgjedhjen e karrierës në të ardhmen.

3. Këshillim dhe orientim në karrierë

1. Prezanton plane afatshurtëra dhe afatgjata, përmes vendimmarrjes për karrierë të mëtutjeshme.

2. Harton planin e zhvillimit personal për realizimin e qëllimeve të veta profesionale.

4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme

1. Zhvillon aktivitete me projekte, punë hulumtuese përmes gjuhëve programuese dhe programeve aplikative.

5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë

1. Harton plan të biznesit duke aplikuar hapat konkretë të realizimit të tij.

6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë

1. Zbaton dhe menaxhon rregullat për mbrojtje dhe siguri gjatë aktiviteteve të ndryshme në shkollë dhe komunitet.

7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme

1. Përdor aplikacione softuerike për përpunimin e të dhënave për aktivitete të ndryshme profesionale.

8. Komunikimi në / për jetë dhe punë

1. Aplikon burime të ndryshme të informimit për zhvillim personal dhe profesional.

9. Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe mjedisit

1. Vlerëson faktorët që ndikojnë në ngrohjen globale dhe arsyeton ndikimin e TIK në këto ndryshime.

2. Prezanton projekte kreative për ruajtjen e mjedisit duke përdorur aplikacione të ndryshme.